# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-453985**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Aeroporti i Vlorës, MIE fiton përballjen e parë me Pacollin: Hyn në fuqi zgjidhja e Kontratës së Koncesion it |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/17/aeroporti-i-vlores-mie-fiton-perballjen-e-pare-me-pacollin-hyn-ne-fuqi-zgjidhja-e-kontrates-se-koncesionit/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 06:49:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 22:00:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 16 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `eeaefb59a9edd3dd6c6fc0ca44661517c6c6eae04a1c08da2fabb7ed809e4ee5` |
| TEKSTI | `e9aa300d820720e413f4d2012787a6d0ad358289d507322bc2db986cd5cd3e57` |
| PAMJA | `893027f32dbc6148390172baca64be205ae28916b94b0c226e097fef902c1674` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9e0178516a1c5686f88d0f1371d0686a93d94d6f16c6fac6e66bb7efe8eb29c9` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9e0178516a1c5686f88d0f1371d0686a93d94d6f16c6fac6e66bb7efe8eb29c9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Aeroporti i Vlorës, MIE fiton përballjen e parë me Pacollin: Hyn në fuqi zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

Aktualitet

Publikuar: 17/09/2026



Arbitri i Emergjencës ka rrëzuar kërkesën kryesore të kompanisë VIA për pezullimin e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës.

Sipas një njoftimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, urdhri është nxjerrë më 16 shtator 2026, në kuadër të procedurave të arbitrazhit të urgjencës të nisura nga VIA, koncesionari i aeroportit.

MIE e konsideron vendimin një zhvillim të rëndësishëm në favor të saj, pasi Arbitri i Emergjencës ka rrëzuar plotësisht dy nga tri kërkesat e paraqitura nga VIA dhe nuk ka pranuar kërkesën kryesore për pezullimin e zgjidhjes së kontratës.

Sipas ministrisë, Arbitri nuk pranoi të pezullonte as zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit dhe as zbatimin e Njoftimit për Zgjidhje. Në vendim është vlerësuar se kontrata dhe provat e paraqitura nuk ofronin bazë të mjaftueshme ligjore për një masë të tillë.

Për rrjedhojë, sipas MIE-së, zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi.

Arbitri ka rrëzuar gjithashtu kërkesën e VIA-s që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të detyrohej të merrte pjesë në ndërmjetësim dhe të caktonte një ndërmjetës. Nuk është pranuar as kërkesa për shtyrjen me dy muaj të fillimit të arbitrazhit.

Megjithatë, VIA ka siguruar një masë të përkohshme. Arbitri ka urdhëruar MIE-në që, për një periudhë të kufizuar, të mos ushtrojë disa prej të drejtave që lindin pas zgjidhjes së kontratës së koncesionit.

Kjo masë do të qëndrojë në fuqi deri në konstituimin e tribunalit

Me te lexuarat


Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pjesëtarëve...


Doktor Maiu, dyqan rrobash te Rruga e Kosovarëve dhe biznes shit-blerje pronash, dërgesa parash të...


Çoi padashje një video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares në...


Historia e gjeneralit kroat të Bosnjes që vrau veten me helm në sallën e gjykimit në Hagë sapo dë...


Furnizoi Millosheviçin me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e ...

të arbitrazhit dhe momentin kur ky tribunal të jetë në gjendje të shqyrtojë mosmarrëveshjen.

Sipas MIE-së, masa e përkohshme nuk prek vlefshmërinë apo efektshmërinë e zgjidhjes së kontratës së koncesionit.

Një tjetër element i vendimit lidhet me kostot e procedurës së urgjencës. Sipas njoftimit, Arbitri i Emergjencës ka urdhëruar VIA-n të përballojë shpenzimet e këtyre procedurave.

Ministria deklaron se tashmë do të përgatisë hapat e mëtejshëm që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës, duke respektuar masën e përkohshme të vendosur deri në konstituimin e tribunalit.

MIE njoftoi gjithashtu se do t'i komunikojë VIA-s se zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi.

Mosmarrëveshja për Aeroportin e Vlorës nuk mbyllet me këtë vendim. Çështja pritet të kalojë për shqyrtim përpara tribunalit të arbitrazhit, i cili do të trajtojë në themel pretendimet e palëve.

TAG: Aeroporti i vlorës

## Të ngjashme



**Ngërçi me pagat, Shoqata Europiane e Gjyqtarëve: Jemi të shqetësuar, ligjvënësit po përpiqen të anashkalojnë vendimin e Kushtetueses!**



**"Jo në emrin tonë1"/ Studentët në Prishtinë marshim proteste në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së**



**Botoxi kontrabandë fryhet për "Gremi Wellness" dhe shfryhet për "Keit", si u mbyll dosja për doktorin e VIP-ave, Skerdi Faria!**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT


Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.